



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës  
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezi

DATE/A:	26.06.2023
PËR:	Marigona Lahu, Nënkryetare
NGA:	Saranda Stublla, Drejtor i DPKGJ-së
TEMA:	Raport pune për periudhën kohore Janar-Qershor 2023
Nr.Pro:	08-401/04-0043073/23

**1. PËRMBLEDHJE** - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarevajtjes/ecurisë së punës:

Drejtoria për pronë, kadastër dhe gjeodezi konkretisht zyra kadastrale komunale (ZKK) e Podujevës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetar duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhuruara për pronat e paluajtshme.

Gjatë periudhës kohore Janar 2023 – Qershor 2023 pran sektorit për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi në zyrat pritëse janë pranuar gjithsej 5,240 kërkesa nga të cilat janë aprovuar 5,203 kërkesa, të anuluar dhe refuzuar janë 6 kërkesa, kurse kanë mbetur në procedurë edhe 31 kërkesa, pra mund të themi se 99.3% e të gjitha kërkesave të pranuar pran zyrës pritëse janë aprovuar dhe kan marrë përgjigje meritore.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA** – Aktivitetet e planifikuara të drejtorisë për pronë, kadastër dhe gjeodezi janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastral
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave
- Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të palëve dhe institucioneve
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë dhe parcelave,
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave dhënen e çertifikatës së pronësis dhe kopjës së planit
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri,
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licensuara,
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.
- Shqyrtimi i kërkesave mbi uzurpimet e pronës komunale
- Përgaditjen e materialit për shpronësim sipas kërkesës së Kuvendit Komunal të drejtuar qeverisë.
- Menaxhimin e të hyrave monetare për pronën komunale të dhënë me qira.

### **3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA NË SEKTORIN E KADASTRIT DHE GJEODEZISË**

- 1254 kërkesa për regjistrimin e bartjës së pronësisë, ndarje, bashkim, përcaktim dhe ri-rregullim të njësive kadastrale ku prej tyre janë aprovuar 1239 sosh apo thënë në % janë aprovuar 98.8%, po ashtu janë refuzuar 13 kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 2 aktvendime për pezullim të përokohshëm të procedurës deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse.
- 9 kërkesa për historiate nga persona fizik dhe juridik që të gjitha janë aprovuar.
- 31 kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe 27 kërkesa për çregjistrim të hipoteke prej të cilave janë aprovuar të gjitha
- 16 përmirësime të çertifikatave të pronësis dhe aktvendimeve të ndryshme prej të cilave janë aprovuar që të gjitha
- 5 kërkesa për shënimin e barrës tatimore mbi paluajtshmërin prej cilave janë aprovuar që të gjitha prej cilave janë aprovuar që të gjitha.
- 3 kërkesa për shënimin e masës së sigurisë mbi paluajtshmërinë dhe 5 lirime të masës së sigurisë mbi paluajtshmërin prej cilave janë aprovuar që të gjitha
- 3,861 kërkesa për lëshimin e çertifikatave të pronësis, kopje të planit, koordinata për njësi, vërtetim që pala nuk posedon paluajtshmëri prej të cilave janë aprovuar që të gjitha.

### **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA NË SEKTORIN E PRONËS**

- 2 kërkesa të uzurpimeve të pronës komunale prej cilave janë aprovuar që të gjitha.
- 36 shkresa dërguara organeve tjera
- 15 Njoftime për përmbarim
- 12 kërkesa për shëndërrim të pronës private në pronë Komunale me destinim të rrugës prej cilave janë aprovuar që të gjitha.
- 17 kërkesa për dhënjën e kopjes së Aktvendimit të vjetër prej cilave janë aprovuar që të gjitha.
- 1 Shkëputje të Kontratës mbi qiran  
64 Njoftime për pagesë të qirasë
- Shpronësimi i pronave të Kooperativës Bujqësore – Podujevë në ZK: Livadicë, Surkish dhe Obrangjë me sipërfaqe prej 457,292.41 m<sup>2</sup> të cilat kalojnë në pronë të Komunës së Podujevës.

### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

Nga sektori i pronës, kadastrit dhe gjeodezis aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët në shpallje publike që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral.
- Lëndët e dërguara në KPA verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave.
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.